



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Seanca plenare e Kuvendit
S-044
Prishtinë, më 15, 23 dhe 24 tetor 2015

P R O C E S V E R B A L

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 15, 23 DHE 24 TETOR 2015

Seancën e kryesoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit HALITI, nënkryetar i Kuvendit.

Në fillim të seancës, deputetët e grupeve parlamentare të opozitës dolën para foltores së Kuvendit, hodhën gaz lotsjellës në sallën e seancës plenare dhe e pamundësuan zhvillimin e punimeve të Kuvendit.

Kryetari dha pauzë.

Pas pauzës, deputetët e grupeve parlamentare të opozitës përsëri dolën para foltores së Kuvendit, hodhën përsëri gaz lotsjellës në sallën e seancës plenare dhe e pamundësuan zhvillimin e punimeve të Kuvendit.

E premte, 23 tetor 2015

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 15 tetor 2015

Kryetari i hapi punimet për vazhdimin e seancës plenare, por deputetët e grupeve parlamentare të opozitës përsëri dolën para foltores së Kuvendit, hodhën gaz lotsjellës në sallën e seancës plenare dhe e pamundësuan zhvillimin e punimeve të Kuvendit.

Kryetari dha pauzë dhe e thirri mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit për t'u konsultuar për zhbllokimin e seancës plenare.

* * *

Vazhdim i seancës, pas pauzës

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 23.10. 2015, me qëllim të zhbllokimit të seancës, kishte marrë vendim me të cilin kishte kërkuar veprime plotësuese, duke përfshirë hyrjen e zyrtarëve të Policisë në sallën e seancave plenare për ta mbrojtur shëndetin e deputetëve dhe për siguruar mbarëvajtjen e punimeve të seancës plenare.

Zyrtarët e Policisë, në bazë të vendimit të Kryesisë së Kuvendit, ishin vendosur në platonë e sallës së seancave plenare për të pamundësuar depërtimin e deputetëve në drejtim të ulëseve të Kabinetit qeveritar dhe të drejtuesit të seancës.

Kryetari procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vazhdim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarim jashtë rendit të ditës paraqiti deputeti Ramush Haradinaj, diskutimi i të cilit është dhënë i plotë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Asnjë deputetë nuk parashtroi pyetje parlamentare.

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Kuvendi e miratoi pa vërejtje procesverbalin e seancës plenare, e mbajtur më 17 e 22 shtator dhe 1 e 8 tetor 2015.

Deputetët e grupeve parlamentare të opozitës sërish hodhën gat lotsjellës në sallën e seancës plenare dhe e pamundësuan zhvillimin e punimeve të Kuvendit.

Kryetari dha pauzë.

* * *

E premte, 24.10.2015

Vazhdim i seancës, ora 1:15

Pas pauzës, në pamundësi për t'i vazhduar punimet në sallën e seancave plenare, Kryesia e Kuvendit, në mbështetje të nenit 4 të Rregullores së Kuvendit, kishte vendosur që seanca plenare t'i vazhdojë punimet në sallën alternative të seancave, në ndërtesën e Kuvendit, kati 4.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 65 deputetë dhe procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetin mendor

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për shëndetin mendor dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ai e ftoi përfaqësuesin e Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Deputeti Fadil Beka e paraqiti dhe e arsyetoi raportin me rekomandime të Komisionit FunkSIONAL.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e Komisionit FunkSIONAL. Kuvendi me shumicë vota i miratoi amendamentet nga nr. 1 deri te amendamenti nr. 42.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamente e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për 65,
Kundër 0,
Abstenime 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri e miratoi Ligjin nr. 05-L/025 për shëndetin mendor.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për shëndetin mendor dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ai e ftoi përfaqësuesin e Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Deputeti Fadil Beka e paraqiti dhe e arsyetoi raportin me rekomandime të Komisionit FunkSIONAL.

Për amendamentet e paraqitura diskutoi edhe deputeti Hatim Baxhaku.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e Komisionit FunkSIONAL dhe të deputetit Bekim Haxhiu.

Deputetit Bekim Haxhiu e tërhoqi amendamentin nr. 6.

Kuvendi me shumicë vota i miratoi amendamentet nga nr. 1-5 dhe amendamentet nr. 7 deri nr. 20.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamente e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për 65,
Kundër 0,

Abstenime 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri e miratoi Ligjin nr. 05-L/023 për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri.

6. Emërimi i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Raportin me rekomandime të Komisionit FunkSIONAL e arsyetoi deputetja Selvie Halimi.

Kryetari e hodhi në votim propozimin për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për 62,
Kundër 0,
Abstenime 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

1. Elbasan Dervishaj emërohet anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1 e këtij vendimi zgjat dy (2) vjet.

7. Emërimi i anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas

Kjo pikë, me kërkesë të ministrit të Drejtësisë, z. Hajredin Kuçi, u shty për seancën tjetër të radhës.

8. Emërimi i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore

Raportin e Komisionit FunkSIONAL e paraqiti dhe e arsyetoi deputetja Selvie Halimi.

Lidhur me raportin e Komisionit FunkSIONAL diskutuan edhe deputetët Armend Zemaj dhe Myfera Shinik.

Kryetari e hodhi në votim propozimin për emërimin e anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për 61,
Kundër 0,
Abstenime 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

për emërimin e anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore

1. Abdulla Aliu emërohet anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1 e këtij vendimi zgjat një (1) vit.

9. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një anëtari të Bordit të RTK-së nga komuniteti serb

Kryetari kërkoi nga grupet parlamentare që t'i propozojnë deputetët për Komision ad hoc.

Kryetarët e grupeve parlamentare i propozuan deputetët për këtë komision.

Kryetari i hodhi në votim propozimet e grupeve parlamentare.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për 62,
Kundër 0,
Abstenime 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, në këtë përbërje:

1. Xhevahire Izmaku nga GP i PDK-së, kryesuese,
2. Salih Morina nga GP i LDK-së, zëvendëskryesues i parë,
3. Srgjan Popović nga GP i LS, zëvendëskryesues i dytë,
4. Zenun Pajaziti nga GP i PDK-së, anëtar,
5. Sadri Ferati nga GP i LDK-së, anëtar,
6. _____, nga GP "Vetëvendosje", anëtare,
7. _____ nga GP i AAK-së, anëtar,
8. _____ nga GP "Nisma", anëtar dhe
9. Kujtim Paçaku nga GP "6+", anëtar,

II. Komisioni ad hoc, në bazë të nenit 26 pika 2.3 të Ligjit nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës duhet t'i shqyrtojë dhe t'i përzgjedhë kandidaturat e paraqitura për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

10. Propozimi i grupeve parlamentar për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryetari i hodhi në votim propozimet e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe të Grupit Parlamentar “Nisma për Kosovën” për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

1. Deputeti Glauk Konjufca nga Grupi Parlamentar LVV emërohet anëtar në Komisionin për Punë të Jashtme, në vend të deputetes Puhie Demaku.
2. Deputetja Valdete Bajrami nga Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” emërohet anëtare në Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, në vend të deputetit Fatmir Limaj.
3. Deputeti Enver Hoti nga Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” emërohet anëtar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në vend të deputetes Valdete Bajrami.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 1:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

E përgatiti:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale